



VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROSEVAC NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.1594/15

30.09 2017

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PËRGJITHËSHËM** si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari i vetëm gjykues Hysnije Gashi, dhe zyrtare ligjore Albana Ujupi, në çështjen penale kundër të pandehurit, [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.1700-1/15 të datës 18.12.2015, në praninë e përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Veton Shabani, të pandehurit pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më dt. 11.05.2017, muarr dhe publikisht shpalli këtë :

### AKT GJYKIM

I pandehuri:

[REDACTED] I, i lindur me [REDACTED], në të njëjtin vend, me vendbanim në fshatin [REDACTED] Komuna Ferizaj, nga i ati [REDACTED] i pa martuar, punëtor në kompaninë [REDACTED] i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, nr. personal [REDACTED]

### ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Më datë 05.09.2015, rreth orës 18:00, në pyllin publik, në vendin e quajtur "Plehnia", në Rajonin Ekonomiko Pyjor, Neredime - Jezercë, i pandehuri me qëllim të përvetësimit pasuror të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, me sharre motorike ka prerë 3 copë trugu të llojit ah, me dimensione të gjata boniteti III, me diametër 60-80cm, me vëllim të përgjithshëm prej 13, 16 m<sup>3</sup>, duke i transportuar me

traktor IMT-539, me ç' rast DBP - zyra në Ferizaj i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 1776.60 €, -

**-me të cilën kreu veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të nen. 4,7,21,41,49,50,51,52,73 të KPK-së në përputhje me men. 365 të KPPK-së të pandehurin e

## **G J Y K O N**

### **DËNIM ME GJOBË DHE ME KUSHT**

I. I shqiptohet dënim, me gjobë në lartësi prej 200 (dyqind) €.

Nëse ky dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara në nen.46 par. 3 të KPK-së , në të kundërtën do të zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20€ i pandehuri do të vuaj 1 (një) ditë burgu.

II. Dënim me kushte.

Në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 1 /një/ viti nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

E dëmtuara - Drejtoria për Bujqësi, Pylltari në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

I pandehuri, obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 (njëzet) Euro në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit

**A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.II.nr.1700-1/15 te datës 18.12.2015 e ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], për veprën penale **vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së.**

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor më dt.11.05.2017 në të cilin Prokurori i Shtetit Veton Shabani në tërësi mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin të shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligji .

**I pandehuri** [REDAKTUAR] ne shqyrtimin fillestar, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza, jam penduar thel për veprën që e kam bërë, i propozoj gjykatës që të më shqipton një dënim sa me të butë .

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.I të KPPK-së:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri ,

-pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lendes siç janë: procesverbali dhe fletëparaqitja e rojës së pyllit me vlerësim dhe llogaritja e dëmit të pyllit nr. 415/15 i datës 11.09.2015 i Drejtorisë së Bujqësisë, dhe Pylltarisë dhe zhvillimit Rural në Ferizaj, si dhe fotografit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabim faktik.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cili është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari, konfor nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së .

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat, si rrethanë lehtësuese morri, pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte, gjendjen e varfër ekonomike, si dhe e konteston vlerën e dëmit, në mungesë të rrethanave veqanarisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave , të pandehurit i shqiptoi denim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjesë së vepres penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

E dëmtuara - Drejtoria për Bujqësi, Pylltari në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

I pandehuri, obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 (njëzet) Euro në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P.nr.1594/16 dt. 18.05.2017**

Zyrtare ligjore,

Albana Ujupi

**Gjyqtari i vetëm gjykues**

Hysnije Gashi



**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpër mes të kësaj gjykate.